

*“Deri sa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”*

BINDJA E THELLË NË ALLAHUN

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin **ERIXH LIN-NESHRI**

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli i origjinalit:

الشقة فالله

Titulli:

BINDJA E THELLË NË ALLAHUN

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik

2008

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Hyrje

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, mirëpo cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përsëritës dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin - robin e Allahut dhe të dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përsëritës edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Ajo çka po ndodhë për çdo ditë tek muslimanët si: nënçmimi i ndërsjellët, urrejtja në mes vete, problemet, ndarja, përçarja, copëtimi, konfrontimi, hidhërimi etj., të gjitha këto na obligojnë neve që patjetër t'i lëmë dhe të largohemi prej kundërshtimeve mes vete, konfrontimeve, hidhërimeve, nënçmimeve.

Të gjitha këto na obligojnë të mbjellim parimin e vëllazërimit dhe çlirimit e zemrave në gjokset tonë, para se të bëhet vonë dhe para se të na shkojë jeta pa bërë punë të mira. Të gjitha këto na

obligojnë domosdoshmërinë e kthimit sa më shpejt tek Allahu Gjithëfalës dhe i Gjithëfuqishëm; t'i lëmë anash konfrontimet, kundërshtimet, hidhërimet, nënçmimet dhe t'i lutemi Allahut që t'i lartësojë dhe t'i ngritë muslimanët edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, njëherit t'i mbrojë muslimanët nga nënçmimi, poshtërimi, ndarja, përçarja dhe shpërndarja.

Le të jetojnë në këtë dunja (botë) me nderë, fuqi, zhvillim dhe qeverisje, ndërsa në botën tjetër me vendbanimet me të larta të Xhenetit dhe shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit. Kjo do të jetë vërejtje dhe dëshmi se vërtetë - ***“Allahu kurrë nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”*** (Err Rra`d, 11)

Deri sa të arrijmë me këtë parim (maksimë) në çështjet më të rëndësishme dhe më madhore, përpos një pjese që i ka mbrojtur Allahu dhe i ka mëshiruar nga të tjerët, të tjerët janë në shkatërrim të zemrave të tyre dhe të muslimanëve, duke shkaktuar kundërshtime, konfrontime, ndarje dhe përçarje. Duhet të angazhohemi që ta heqim këtë ves të keq dhe virusin shkatërrimtar për të kaluar jetë të lumtur, të qetë dhe të mirë edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Për t'u angazhuar në përmirësimin dhe ndryshimin e gjendjes faktike të mjerueshme, e për të arritur në një gjendje të ndershme, të lartë, të ndërtuar mbi bazat e vëllazërimit, unitetit, fuqisë, krenarisë,

deri tek triumfi dhe qeverisja Islame dhe e muslimanëve.

“Vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre”.

(Err-Rra’d, 11)

* * *

BINDJA NË ALLAHUN

Në këtë ligjëratë do të flas për kuptimin e Imanit të plotë, pa të cilën çështje Imani jonë nuk mund të jetë i qëndrueshëm, pra për thelbin (shpirtin) e Imanit. Edhe pse kjo fjalë ekziston në jetën tonë, por fatkeqësisht ekziston sipërfaqësisht, ekziston vetëm si domethënie tradicionale, e jo si domethënie ibadeti (adhurimi), pra nuk është i rrënjosur në zemra, përpos në ata, të cilët i ka mëshiruar Allahu dhe i ka udhëzuar.

Besimi (thikatun) në Allahun dhe bindja në fuqinë e Tij është tema për të cilën do të flas në projektin madhështor dhe planprogramin madhështor, ku Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, pa e ndryshuar ata gjendjen e tyre:

“Nuk ka dyshim se Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ai popull mos ta ndryshojë gjendjen e tij”.

(Err-rraëd, 11)

Dëshiroj që këtë çështje ta rrënjosi në zemrat tona që të jetë ibadet, e jo që të jetë vetëm formale ose tradicionale. Dëshiroj që në bazë të këtij programi të Allahut të Lartmadhëruar të ndryshoj gjendjen pozitivisht, që ta përmirësoj në baza të diturisë dhe studimit, në baza të kuptimit të plotë, që Allahun e Lartmadhëruar ta adhurojmë me bindje të plotë dhe me dituri të shëndoshë.

Kjo çështje është Imani i fortë, i cili nuk mund të depërtojë menjëherë, në mënyrë automatike, në zemrat tona, por nevojitet punë, angazhim dhe përpjekje e vazhdueshme, e kështu arrihet, me lehtësi, sinqeriteti i robit me Allahun.

Lusim Allahun e Lartmadhëruar që të na forcojë zemrat me Imanë, me bindje të thellë në Allahun, të vendosur stoik për tërë jetën. Po ashtu lusim Allahun që të na mundësojë që të vdesim me Imanë, që Allahu të jetë i kënaqur me ne dhe ne të jemi të kënaqur me Të. Vërtet vetëm Allahut të Lartmadhëruar i lutemi dhe shpresojmë se do të na pranojë lutjet tona.

IMANI I PLOTË DUHET TË JETË I NDËRLIDHUR DREJTPËRSËDREJTI ME ALLAHUN, E JO NË BAZË TË KUSHTEVE DHE RRETHANAVE

Bindja dhe besimi në Allahun duhet të jetë i pakufishëm.

Ne, në jetën tonë shohim çështje të cilat nëse i vështrojmë dhe i analizojmë do të kuptojmë se Allahu gjithherë është me ne, u ndihmon të dobëtëve tanë, i përgjigjet lutjeve tona. Lavdërimi dhe Madhërimi qoftë për Allahun, të Cilit i drejtohem i Cili na përgjigjet. Mirëpo, unë kam frikë për umetin tonë prej një çështjeje shumë të rrezikshme, pra, a e dini se cila është ajo çështje?

Frikësohem se besimi ynë në Allahun është i ndërlidhur vetëm në bazë të rrethanave dhe ndodhive.

Lus Allahun që kjo mos të jetë prezente tek ne. E kemi për detyrë të tërheqim vërejtjen në një çështje shumë të rëndësishme, e ajo është:

Që besimi ynë në Allahun e Lartmadhëruar të mos jetë i ndërlidhur me shkaqet dhe rrethanat, por besimi ynë në Allahun e Lartmadhëruar të jetë i ndërlidhur drejtpërsëdrejti me Allahun, i Cili nuk ka ortak, as rival. Sepse Ai është Allahu, nuk ka zot pos Tij, vetëm Atij i takon sundimi, vetëm Atij i takon forca, fuqia, madhështia, Ai nuk ka ortak, as rival. Ai ka mundësi për çdo send; që besimi ynë të jetë i

ndërlidhur me Allahun e Lartmadhëruar, i Cili nuk ka ortak, as rival, dhe se Ai është i fortë, i fuqishëm, mbizotërues dhe i pamposhtur;

që besimi ynë të jetë i ndërlidhur me Allahun e Lartmadhëruar, i Cili nuk ka ortak, as rival, dhe se Ai është mbizotërues i çdo sendi, Caktues, Precizues, i Lartë, Sundimtar absolut.

Munafiku është larg prej Allahut të Lartmadhëruar, ai besimin e ka të ndërlidhur në Allahun në bazë të rrethanave dhe suksesit; nëse shkaqet ndryshojnë edhe sukcesi i tij luhetet, luhetet edhe besimi i tij në Allahun dhe largohet (konverton). Zoti na ruajt prej imanit të dobët dhe të dyshimtë!

Ndërsa sa i përket besimtarit të sinqertë, besimi i tij në Allahun është bindje e plotë dhe thellë e ngulitur, ai nuk zmbrahet dhe nuk lëkundet asnjëherë, por përkundrazi imani i forcohet dhe i shtohet. Sa më shumë ndryshojnë rrethanat dhe i mungojnë sukseset, i shtohen vështirësitë, i paraqiten pasojat, aq më shumë i shtohet bindja dhe besimi në Allahun e Lartmadhëruar. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe posa panë besimtarët aleatët (kundër tyre) thanë: Kjo është ajo çka na ka premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij”. (El-Ahzab, 22)

Koalicioni i pabesimtarëve kur u nis për në Medine për të çrrënjosur dhe shkatërruar islamin dhe muslimanët, ishin rrethanat asi soji për t'u lëkundur besimtarët, mirëpo kurrë nuk lëkunden zemrat të cilat

i ka konstruktuar Allahu i Lartmadhëruar, dhe as nuk dobësohen, as nuk dorëzohen, përkundrazi imani i besimtarëve vetëm se forcohej edhe më shumë, kështu që Allahu u ndihmoi atyre dhe i shkatërroi armiqtë e tyre.

Bëhet pyetja: Si e forcojnë besimtarët Imanin në Allahun e Lartmadhëruar në momentet e krizave, vështirësive dhe sprovave?

Besimtarët e forcojnë besimin e tyre në Allahun edhe në momentet e krizave, vështirësive dhe sprovave, kur ta kenë bindjen e plotë në Allahu e Lartmadhëruar, dhe kurrë nuk dorëzohen besimtarët, të cilët i nënshtrohen dhe i përmbahen Allahut.

Besimtari e beson me bindje të plotë dhe të përhershme se çka cakton Allahu, dhe çka vepron Allahu i Lartmadhëruar, edhe pse nga jashtë duket e keqe, në brendi është e mirë, bile edhe mirësi e vërtetë. Duaja e Pejgamberit s.a.v.s. ka qenë:

“TË PËRGJIGJEM O ZOT, E TËRË MIRËSIA ËSHTË TE TI, E KEQJA NUK ËSHTË TE TI, UNË JAM I KRIJUAR PREJ TEJE DHE KTHIMI IM ËSHTË TE TI. BEKIMI DHE MADHËRIMI TË TAKON VETËM TY”.

(SAhih Muslim, 1290)

E tërë mirësia është prej Allahut të Lartmadhëruar. E tërë mirësia është e Islamit dhe muslimanëve, nën ombrellën e përmbajtjes së Ligjit të Allahut të Lartmadhëruar, nën ombrellën e praktikimit të planprogramit të Allahut, i Cili është i projektuar për të qenë të lumtur robërit musliman.

Nuk ka vend për pesimizëm dhe humbje të shpresës. Nuk humbet shpresa në mëshirën e Allahut dhe nuk duhet dorëzuar, por përkundrazi duhet të shtohet shpresa dhe bindja në Allahun, edhe pse përsëriten, shtohen sprovat dhe fatkeqësitë.

Nuk ka lëkundje në bindje në Allahun, dhe kthim mbrapa s'ka, por kuptim të plotë, perceptim dhe bindje të fuqishme në Allahun, i Cili mposhtë gjithçka, dhe feja dhe ligji i Tij është triumfues.

Allahu i Lartmadhëruar nuk u jep fuqi, nuk u ndihmon dhe nuk lejon të dominojnë e të qeverisin parazitët, koprracët, të paafitit dhe dembelët. Allahu i Lartmadhëruar për të na ndihmuar dëshiron që të na zgjojë; duhet ta dimë se të gjitha këto sprova, kriza dhe probleme të cilat janë tubuar në umetin tonë nuk janë rezultat i paaftësisë së Allahut të Lartmadhëruar, dhe se Ai nuk ka mundësi t'i largojë. Zoti është i pastër nga kjo! Ai ka fuqi, ka mundësi, dhe nuk është ajo se Zoti do që robërit e Tij besimtarë të jenë të nënçmuar ashtu qysh të tjerët e quajnë, por e gjithë kjo është që të zgjohen të logjikojnë dhe të kuptojnë muslimanët. E gjithë kjo është që të kthehen muslimanët në parimin dhe ligjin e Allahut:

“Nuk ka dyshim se Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ai popull mos ta ndryshojë gjendjen e tij”.

(Err-rraëd, 11)

Kur çdo musliman e ndryshon veten e tij në atë çka Allahu është i kënaqur, atëherë Allahu ndryshon gjithçka dhe i drejton të gjitha çështjet në dobinë tonë me dëshirën e Tij, për t'i nderuar, dhe respektuar robërit e Tij besimtarë.

MBJELLJA E BINDJES NDAJ ALLAHUT NË ZEMRAT E ROBËRVE TË TIJ

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar, që të na mësojë vetëbesimin në Allahun, i cakton çështjet të cilat tregojnë aftësinë dhe fuqinë e Tij, dhe gjithëpërfshirjen e Tij në të gjitha çështjet.

Allahu i Lartmadhëruar i ka caktuar ligjet, që në përgjithësi janë ekzakto, të pandryshueshme, atë çka ne sot e shohim dhe e përjetojmë, sikurse ligji i zjarrit për të djegur, ujit për të fikur zjarrin etj, etj. Mirëpo Allahu, me fuqinë e Tij, këto ligje mund t'i ndryshojë, ashtu që, në disa raste na tregojnë se Ai e bën të kundërtën e asaj që për ne është e njohur. Sa që na shpëton prej djegies dhe shkatërrimit, dhe bën që zjarri apo vetë shkatërruesi të shkatërrohet. Këtë e bën vetëm për të na mësuar bindjen, besimin në fuqinë e Tij, e jo në shkaqe e rrethana, sepse Allahu është krijues i atyre ligjeve, shkaqeve dhe rrethanave. Këtë mund ta paraqesim me shumë shembuj, por ne po i përmendim vetëm disa prej tyre:

SHNDËRRIMI I NATYRSHMËRISË SË ZJARRIT NË FTOHJE DHE SHPËTIM

Kur populli pabesimtar i Ibrahimit a.s. e ka gjuajtur atë në zjarr, ai ishte stoik i vendosur dhe kishte bindje të fortë në Allahun e Lartmadhëruar. Allahu i Lartmadhëruar e përkrahi dhe i ndihmoi, sa që zjarri djegës u bë ftohës dhe e shpëtoi Ibrahimin a.s.

Shpëtimi i Ibrahimit a.s., në formën që zjarri të mos e djegë atë, është ilustrimi dhe mësimi më i madh se sa vetëm këshillat me fjalë, dhe më sqaruesi i fuqisë së Allahut, dhe mundësisë së Tij, për ta ndryshuar ligjin e natyrës, ligjin të cilin të gjithë njerëzit e dinë.

Allahu i Lartmadhëruar ka pasur mundësi që ta shpëtojë Ibrahimin a.s. ndryshe dhe me forma të tjera. P.sh. të dërgojë zë nga qielli e të zbresë shi për ta shuar zjarrin, dhe çdo herë që ata ta ndiznin zjarrin shiu ta fikte. Ose t'ia mundësojë Ibrahimit a.s. ikjen prej tyre. Mirëpo, Allahu i Lartmadhëruar ka dëshiruar që ta vulosë bindjen e fortë në zemrat tona.

Allahu i Lartmadhëruar e ka mposhtur ligjin natyror, të cilin Ai e ka vendosur - pra që zjarri të mos djegë. Ata e kanë gjuajtur në zjarr dhe kanë thënë:

“Ndizeni zjarrin (që të digjet) ai (Ibrahimi) dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni që të bëni veprim çka dëshironi”. (El-Enbija, 68)

Mirëpo çka ndodhi, mjerë për ta, mjerë për ta që nuk e kanë ditur fuqinë dhe mundësinë e Allahut të Lartmadhëruar:

“Ne thamë: O zjarr, bëhu i ftohtë dhe qetësoje e sill shpëtim për Ibrahimin! Kështu ata dëshiruan që ta lajkatojnë (ta nënçmojnë), por përkundrazi, Ne ata i bëmë më të dëshpëruarit dhe më të dështuarit”. (El-Enbija, 69, 70)

UDHËZUESI I RRRITUR NË SHTËPI KRIMINELE

Çështja e cila e forcon bindjen e plotë në Allahun është analitika në veprimin e Allahut të Lartmadhëruar dhe mënyra e aktivitetit të tij në ligjet e gjithësisë, dhe të krijesave. Ai, i cili i analizon këto, vëren se veprimet e Allahut ndonjëherë i ndryshojnë rrethanat, për arsye dhe urtësi të përsosur, të cilën nuk e di askush tjetër, pos Allahut të Lartmadhëruar.

Allahu i Lartmadhëruar i ndryshon ligjet e gjithësisë, cakton diçka që është e kundërt me atë çka e ka caktuar më parë. Kështu p.sh. shohim se si udhëzuesi del prej shtëpisë së kriminelit.

Musa a.s. është Imam (prijës) i udhëzuesve i cili është ushqyer, është rritur dhe ka qenë në

përkujdesje të prijësit të shkatërrimtarëve, me qëllim që në vend se të jetë qetësim për të, në të ardhmen, të jetë armik dhe pikëllim për të. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe Ne, e frymëzuar nënën e Musas që t’i jep gjë dhe posa ta ndiesh rrezikun për të (se do ta mbysin) gjuaje në det (lum) dhe as mos u frikëso, e as mos u pikëllo. Se vërtet Ne do ta kthejmë prapë tek ti, dhe do ta bëjmë prej të dërguarve. Dhe familja e Firaunit e përvetësoi atë, e që pastaj të bëhet armik, pikëllim dhe dëshpërim për ta. Me të vërtet Firauni e Hamani, dhe ushtria e tyre, kanë qenë mëkatarë dhe kriminelë”. (El-Kasas, 7, 8)

Zoti i Lartmadhëruar tregon se si Firauni (Zoti e mallkoftë) i ka thënë atij (Musës a.s.):

“A nuk jemi përkujdesur dhe a nuk të kemi rritur ne derisa ke qenë foshnje për shumë vite”.

(Esh-Shuaraë, 18)

Vëlla!! Shiko planifikimin e Zotit të Lartmadhëruar!! Pse Zoti i Lartmadhëruar e ka caktuar që Musa a.s. të rritej, të edukohet dhe të jetë në përkujdesje të shtëpisë së Firaunit, e jo diku tjetër?!

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar ka dëshiruar që të mbjellë te robërit e Tij bindjen e plotë në Të.

Ajo çka është më e rëndësishmja dhe më kryesorja, e cila e forcon bindjen e thellë në zemrën tënde, te tregimi i Musës a.s. me Firaunin, Zoti e pastë mallkuar, është se Firauni ka parë ëndërr se do të lind

një djalë, i cili do të jetë shkak i shkatërrimit të tij dhe, i cili do t'ia merr fronin. Për këtë arsye ai foshnjat meshkuj të porsalindura i vriste dhe i masakronte. Mirëpo caktimit të Zotit askush nuk mund t'i ikë, as t'i shmanget. Fuqia e Allahut është e pakufishme, edhe pse Firauni të gjitha foshnjat meshkuj i ka mbytur. Zoti i Lartmadhëruar angazhimin e tij ia ka dështuar me Musain a.s.. Pasi që ai të gjithë i ka mbytur, por vetëm Musain a.s. jo, por jo vetëm se nuk e ka mbytur, por edhe e ka rritur.

SHPËRTHIMI I UJIT NGA GURI

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe përkujto atëherë kur Musa a.s. kërkoi ujë për popullin e tij. Dhe Ne i thamë: Bjeri gurit me shkopin tënd. Ai i ra: Dhe menjëherë shpërthyen dymbëdhjetë burime. Dhe secili fis e dinte vendburimin e tij. Hani dhe pini prej furnizimeve të Allahut dhe mos u bëni shkatërrimtarë në fytyrën e tokës”. (El-Bekare, 60)

Një ditë prej ditëve, populli i Musa a.s. u gjend në kohë shumë të vështirë, në krizë natyrore, sa që nuk kishte ushqim, përroskat dhe lumenjtë ishin shterë, kafshët kishin ngordhur, bimët ishin tharë. Vdekja e merrte çdo ditë nga një. Ata nuk kishin zgjidhje tjetër, pos të kërkojë Musa a.s. prej Zotit që të bie shi. Musa a.s. e pranoi kërkesën e tyre dhe iu

lut Zotit të Lartmadhëruar për të zbritur shi nga qielli, duke i ngritur duart lartë. Mirëpo çdo pikë shiu i cili zbret, zbret nga qielli, ndërsa Zoti i Lartmadhëruar ka dëshiruar që atij t'ia pranojë lutjen, t'i sjellë shi, por prej aty ku ata as që mund ta paramendonin, as që mund ta logjikonin, për të përforcuar bindjen në Njeshmërinë e Lartmadhërisë së Allahut, kështu që urdhëron Musën a.s. që t'i bie me shkop gurit. Musa a.s. i bie gurit dhe menjëherë prej gurit kanë shpërthyer dymbëdhjetë burime, dhe të gjithë kanë pirë ujë, dhe janë mahnitur!!

Mirëpo, parashtrohet pyetja:

Pse uji të burojë prej gurit dhe jo prej zbritjes së shiut?!

Kjo është fuqia e Allahu të Lartmadhëruar. Ky është planprogram i Allahut të Lartmadhëruar për ta vërtetuar tek të tjerët fuqinë e Tij, për t'i mësuar dhe për t'i edukuar robërit e Tij, për t'i edukuar robërit e Tij dhe për t'i bindur robërit e Tij në njeshmërinë e Tij, i Cili nuk ka shok.

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar me këtë ka dashur që të na mësojë se Ai është Sundimtari absolut, Gjykuesi absolut, Caktuesi i çdo çështjeje.

Vërtet besimtari është krijesa më e lumtur në tokë, sepse ai ka besim dhe bindje të plotë në Allahun e Lartmadhëruar, dhe ka bindje të plotë në fuqinë e Tij.

ALLAHU I LARTMADHËRUAR NGJALLË TË VDEKURIN NËPËRMJET TË VDEKURIT

Tek beni Israilët një njeri ishte vrarë, mirëpo ata nuk e dinin vrasësin. Beni Israilët, për këtë çështje, u konfrontuan mes vete. Zoti i Lartmadhëruar ia shpalli Musa a.s. për ta prerë lopën, për ta marrë një pjesë prej saj dhe për t'i mëshuar të vرارit me atë pjesë, me qëllim që të vdekurit t'i kthehet shpirti dhe të tregojë emrin e vrasësit, dhe kjo u realizua me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Pra, Allahu i Lartmadhëruar e ka ngjallë të vdekurin prej të vdekurës, e cila është plotësisht në kundërshtim me logjikën njerëzore. Këtë e ka bërë Allahu i Lartmadhëruar shembull dhe këshillë për beni Israilët dhe për popujt pas tyre, për të përforcuar bindjen në zemrat e tyre, për t'i mësuar ata se Ai është planifikues, faktues dhe se ligjet në natyrë që të gjitha janë prej dëshirës së Tij dhe se ato manifestohen prej Tij. Vëlla!! A beson në Zotin e Lartmadhëruar apo nuk beson?! A beson në fuqinë e Zotit të Lartmadhëruar apo jo?!

TORTURAT DHE SULMI NDAJ MUSLIMANËVE SHKAK I PËRHAPJES SË ISLAMIT DHE UDHËZIMIT NË RRUGËN E DREJTË

Ta dish, thirrësi ndonjëherë përpiqet maksimalisht në aftësinë e tij dhe me mënyrën e tij, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar ia mbyll mënyrën e tij, për t'i hapur rrugë veprimit tjetër, për t'ia mësuar atij mbështetjen te Zoti, për t'ia përforcuar bindjen në Zotin, për t'ia mësuar fuqinë dhe aftësinë e Tij, për t'i udhëzuar dhe për t'i ndihmuar kujt të dojë Ai. Kështu ka ndodhur me të Dërguarin s.a.v.s., i cili thërriste në Meke, ndërsa prej banorëve të Mekës përjetonte torturime dhe ofendime. Pastaj i Dërguari s.a.v.s. fillon të mendojë për të gjetur vend tjetër më të përshtatshëm, për të thirrur në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar, për ta vendosur fenë e Allahut të Lartmadhëruar, ndërsa në atë kohë vendi më i largët për të ishte Medineja. Mirëpo, shtrohet pyetja:

Pse Muhamedi a.s. nuk shkoi në Medine?! Vërtet Pejgamberi s.a.v.s. e shihte se Medineja në atë kohë nuk ishte e përshtatshme për të pranuar thirrjen në rrugë të Allahut, sepse Jehudët ishin të përqendruar në të, ndërsa fisi Evs dhe Hazrexh ishin në konflikt, të vazhdueshëm mes vete, për 40 vite me radhë. Dhe çdo njëri me logjikë të shëndoshë do ta kishte ditur se nuk është kohë dhe vend i

përshtatshëm, mirëpo caktimi i Zotit të Lartmadhëruar i ka ndryshuar të gjitha ligjet normale, sa që Medineja është bërë vendi më i përshtatshmi dhe më i sigurti për të pranuar Islamit, dhe për ta përhapur fenë Islame.

Si dhe pse?!

Sepse Jehudët, para se të dërgohej Muhamedi a.s. pejgamber, çdo herë kur u ndodhte ndonjë konflikt apo armiqësi, thoshin: Ka ardhur koha për të ardhur Pejgamberi i fundit, ne do ta pasojmë atë dhe do t'iu zhdukim juve. Ky ka qenë shkak që banorët e Medinës kanë qenë të flaktë që të paraqitej ai Pejgamber dhe ta pasonin. Ishte shkaku se fisi Evi dhe fisi Hazrexi aq shumë ishin armiqësuar mes vete, aq shumë ishin në konflikt mes vete, sa që ishin tepër të etur për një rregullim të marrëdhënieve mes vete, dhe ndërprerjes së flakës së zjarrit, i cili i kishte dëmtuar për së tepërmi.

Pasi që Pejgamberi s.a.v.s. nuk ishte i përfshirë me edukimin e Allahut në fillim të thirrjes së tij, ai nuk e ka menduar që të shkojë në Medine, prandaj shkon në Taif, për t'iu thirrur banorët e atij vendi në islam, mirëpo ata e pritën me tallje, ofendime dhe sharje.

Kjo rrugë dhe ky vend për ta thirrur në islam edhe pse ishte e lirë dhe e hapur, iu ngushtua pejgamberit a.s. për së tepërmi. Muhamedi a.s. nga Taifi kthehet në Meke dhe pas një muaji takohet me

disa djelmosha të Medinës, të cilët dëshironin ta pranonin Islamin tek Muhamedi a.s., dhe atë pasi që kishin dëgjuar nga Jehudët për paraqitjen e Pegamberit, i cili do ta përfshijë dhe do ta qeverisë tokën, dhe do të triumfojë kundër çdo njeri, i cili e kundërshton. Për këtë arsye ata kishin shpejtuar dhe ia kishin tejkualuar jehudëve dhe iu kishin paraqitur Muhamedit a.s. “SUBHANALLAH” - Qoftë i Lartësuar Allahu, i Cili i ka bërë shkaktarë jehudët që në Medine të përhapet Islami dhe, prej aty, pastaj në gjithë botën:

“Dhe nuk e di ushtrinë e Zoti tënd askush tjetër, pos Tij”. (El-Mudethir, 31)

Qoftë i Lartësuar Allahu, i Cili konfliktin dhe armiqësinë e Evsit dhe Hazrexhit e ka bërë shkak të përhapjes së Islamit në Medine, e prej aty në të gjitha anët e botës:

“Dhe nuk e di ushtrinë e Zotit tënd askush tjetër, pos Tij”. (El-Mudethir, 31)

Qoftë i Lartësuar Allahu, i Cili armiqësinë në mes të Jehudëve dhe banorëve të Medines e ka bërë shkak të përhapjes së Islamit në atë vend, e prej aty në të gjitha anët e botës:

“Dhe nuk e di ushtrinë e Zoti tënd askush tjetër, pos Tij”. (El-Mudethir, 31)

A nuk e forcon kjo bindjen në Allahun?!

Vëlla!! Nuk ka dyshim se Allahu i Lartmadhëruar i ndryshon ligjet natyrore, për të ta forcuar bindjen tënde në fuqinë e Tij. Ai ka mundësi që t'i ndryshojë ligjet e natyrës ashtu siç dëshiron Ai, dhe kur të dëshirojë, për të treguar se Ai është që i vendosë ligjet, po në të njëjtën kohë Ai mund t'i ndryshojë ligjet, e askush tjetër, pos Tij.

Ai dëshiron të na mësojë praktikisht me qëllim që ta përforcojmë bindjen në Të. Ai është Zoti ynë, ndihmëtari dhe mbrojtësi ynë, dhe nuk ka ndihmëtarë, dhe mbrojtës më të mirë se Ai.

A nuk është Allahu Ai, i Cili ka urdhëruar që zjarri të mos e djegë Ibrahimin a.s.?!

A nuk është Allahu Ai, i Cili e ka urdhëruar peshkaqenin që Junusin a.s. ta gëlltitë dhe ta përpijë?!

A nuk është Allahu Ai, i Cili e ka urdhëruar peshkaqenin që ta hedhë të gjallë në bregdet Junusin a.s., ashtu siç ka dëshiruar Ai – i Lartësuari?!

A nuk është Allahu Ai, i Cili Musain a.s. e ka shpëtuar dhe e ka siguruar nga frika, dhe e ka mbrojtur nga humbja?!

A nuk është Allahu Ai, i Cili ka dërguar peygamber të udhëzuar në qendër të një vendi pabesimtarësh?!

A nuk është Allahu Ai, i Cili e ka nxjerrë ujin nga rrënja e shkretëtirës dhe thellësia e gurit?!

A nuk është Allahu Ai, i Cili në kohën e Musait a.s. ia ka ndryshuar cilësinë e ujit (prej ujit të ëmbël në gjak)?!

Allahu i Lartmadhëruar është Ai, i Cili ka mundësi për të gjitha këto, por edhe më shumë, për gjëra të cilat i dimë, dhe të cilat nuk i dimë.

Vëlla!! Bindu në Allahun dhe mos lejo që pesimizmi të zë vend në zemrën tënde. Ta dish se kjo fe është, se kjo është feja e zgjedhur e Allahut, Ai është mbrojtësi dhe ndihmëtari i saj. Kjo fe është drita e Allahut të Lartmadhëruar, me të cilën e ka shndritur botën e njeriut dhe do të jetë gjithmonë dritë, dhe argument, dhe rrugë e mbrojtur deri sa të ekzistojë kjo botë.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dëshirojnë që ta fikin dritën e Allahut me gojë (fjalët) e tyre, ndërsa përkundrazi Allahu e plotëson dritën e Tij edhe pse pabesimtarët këtë e urrejnë”. (Es-Saf, 8)

Fenë e Tij Allahu e ka mbrojtur, e mbron dhe e siguron, e përkrahë, dhe e bën që të triumfojë. Për këtë arsye umeti duhet të ketë bindje të plotë në ndihmën dhe fitoren e Allahut për fenë e Tij, dhe robërit e Tij. Çështja e Allahut të Lartmadhëruar, fuqia e Tij, dëshira e Tij është mbi çdo shkak dhe rrethanë, mirëpo ne duhet të jemi ata, të cilët e meritojnë ndihmën dhe përkrahjen e Allahut të Lartmadhëruar.

Bëhet pyetja, si? Duke iu kthyer praktikimit të ligjit të Allahut se: ***“Nuk ka dyshim se Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ai popull mos ta ndryshojë gjendjen e tij”.*** (Err-rraëd, 11)

Vëlla!!

Të kesh bindje të plotë në Allahun e Lartmadhëruar, mos lejo që pesimizmi të zë vend në zemrën tënde. Nuk ka dyshim se Allahu i Lartmadhëruar e ndihmon fenë e Tij edhe nëpërmjet armiqve të fesë së Tij. Por, si?

Një vëlla musliman më ka dërguar një letër, ku shkruante:

“Ata duke i vrarë vëllezërit tanë, na ngjallin neve dhe na përforcojnë ne në fenë tonë!”.

Po, muslimanët dallohen me një çështje shumë të rëndësishme, e ajo çështje është se, sa më shumë që torturohen, dëbohen dhe shtypen, aq më shumë i kthehen fesë dhe forcohen në fenë e tyre. Feja e Allahut është triumfale. Feja e Allahut është fortifikatë dhe kështjellë e çdo krenari, të ndershmi dhe të larti. Feja e Allahut është fe, e cila ngjallet dhe forcohet në zemrën e çdonjërit, të cilit i vështirësohet gjendja. Ky është realitet i pamohueshëm.

Sa më shumë që bëhet presion në Palestinë, çdonjëri, i cili dëshiron të jetë simpatizant i tyre, në vendet tjera, largohet prej mëkateve dhe i përmbahet ligjeve të Allahut. Në kohë të fundit, ajo çka ndodhi në Irak, ka qenë shkak i zgjimit të shumë muslimanëve në shumë vende të botës.

PEJGAMBERI S.A.V.S. DHE NGULITJA E BINDJES NË ALLAHUN NË ZEMRAT E BESIMTARËVE

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. vazhdimisht i mësonte Sehabët në bindje të plotë në Allahun e Lartmadhëruar, besimin e plotë në Allahun dhe ngulitjen në zemrat e tyre. Ai e ka mësuar Ibn Abasin, i cili ishte djalosh dhe i cili në moshë ishte i ri:

Transmeton Ibn Abasi se një ditë ka qenë me të dërguarin e Allahut s.a.v.s., dhe i ka thënë:

“O djalosh, ruaji detyrat e tua ndaj Allahut, Ai do të të ruaj ty; ruaji detyrat e tua ndaj Allahut, Ai do të jetë me ty. Kur të lutesh, lutu Allahut; kur të mbështetesh, mbështetu Allahut. Ta dish, nëse i tërë populli tubohen për të ta bërë një punë të mirë ty, nuk munden të bëjnë, pos atë çka e ka shkruar Allahu për ty. Po nëse tubohen për të ta bërë një të keqe, nuk munden të të dëmtojnë, pos atë dëmtim çka e ka shkruar Allahu për ty. Lapsat janë ngritur dhe fletët e librit janë terur”.

(SUNENI I TIRMIDHIUT, 2440, i cili ka thënë se ky hadith është hadith Hasen Sahihë. “SAHIH EL-XHAMIE LI SHEJH ALBANI, 7957)

RRUGA MË MADHËSHTORE PËR TË SHTUAR BINDJEN NË ALLAHUN E LARTMADHËRUAR

Ai është Kur'ani fisnik; lexo Kur'anin, vështro dhe analizo ajetet e tij, kupto domethëniet e tij, vepro me to, do të jesh njeriu më i lumturi, më i qeti dhe më i sigurti. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Tek Ai janë çelësat e fshehtësive, dhe nuk i di askush tjetër, pos Tij. Ai di çka ka në tokë e në det, dhe nuk mund të ketë fletë dushku e që mos ta dijë (se ka rënë)”.

Parafytyro sikurse i sheh fletët e dushkut duke rënë para syve tu (e që mos ta dijë (se ka rënë) dhe as një kokërr). Pra çdo kokërr, kudo që të jetë, në çdo vend, nuk bie dhe nuk lëvizë (nuk rritet) vetëm se me dijen, dhe lejen e Allahut, Krijuesit të të gjithë botëve.

“... s’ka as të njomë, as të thatë, e që të mos jetë e shënuar qartë e preciz në librin e qartë”. (El-En’am, 59)

A, pas gjithë kësaj njohurie, ende nuk e ke forcuar bindjen në Allahun e Lartmadhëruar?!

Allahu i Lartmadhëruar thotë: ***“Allahu i merr shpirtrat në çastin e vdekjes (së njerëzve), por i merr edhe ata shpirtra (të njerëzve) që nuk vdesin, por janë në gjumin e tyre, dhe i mban ata që janë caktuar për vdekje edhe i dërgon shpirtrat e tjerë (në trupin e të fjeturve në çastin e zgjimit) për të vazhduar deri në afatin e caktuar”.*** (Ez-Zumer, 42)

Gjumi është vdekje e vogël, për këtë arsye peygamberi i Allahut - Muhamedi s.a.v.s., kur është zgjuar nga gjumi dhe i është kthyer shpirti, na ka këshilluar për lutje.

Transmetohet nga Hudhejfete bin El-Jaman se ka thënë: Muhamedi a.s., kur në mbrëmje shtrihej në shtratin e tij për të fjetur, e vendoste dorën e djathtë të tij nën anën e djathtë të tij dhe thoshte:

“O Zoti im! Me emrin Tënd ngjalle (rizgohem) dhe me emrin Tënd vdes”. Ndërsa kur zgjohej nga gjumi thoshte: *“Falënderoj Allahun, i Cili më ka ngjallur pas vdekjes sime, dhe kthimi im është tek Ai”*. (Musnedi Imam Ahmedit, 22198)

Ebu Hurejrete r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Kur ndonjëri nga ju zgjohej nga shtrati i tij, e pastaj kur përsëri të kthehet në të, me rrobën e tij le ta fshijë tri herë (shtratin), sepse nuk e di çka ka pasur në të, e kur të shtrihet le të thotë: O Zoti im me emrin tënd po e vendosi trupin tim në shtrat dhe me emrin tënd e ngriti nga shtrati. Nëse shpirtin tim e merr, mëshiroje, e nëse e dërgon, dërgoje atje ku janë robërit e tu të mirë, të cilët i ruan”*. Ndërsa kur të zgjohej nga gjumi le të thotë: *Falënderoj Allahun, i Cili e ka siguruar trupin tim dhe e ka kthyer shpirtin, dhe më ka mundësuar që ta kujtoj Atë (Allahun e Lartmadhëruar)”*.

(Suneni i Tirmidhiut, 3323. Ai thotë se hadithi i Ebu Hurejres është hadith Hasen)

Çdo njëri i cili flenë në fytyrën e tokës është e patjetërsueshme që shpirti i tij të kthehet te Krijuesi i tij, pastaj Allahu i Lartmadhëruar ia kthen shpirtin përsëri në trup për të vazhduar deri në afatin e paraparë, ndërsa atij (të fjeturit), të cilit i është caktuar që të vdesë, nuk ia kthen, sepse afati i jetës së tij ka skaduar.

A, pas gjithë kësaj njohurie, ende nuk e ke forcuar bindjen në Allahun e Lartmadhëruar?! Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Atë ditë kur do ta palosim qiellin, sikurse bëhet palosja e fletëve në libër”. (El-Enbija, 104)

Qielli paloset në Ditën e Kijametit ashtu siç palosen fletët në libër.

Allahu Lartmadhëruar thotë:

“Dhe nuk e njohin Allahun aq sa ka fuqinë e Tij, e toka në përgjithësi në ditën e Kijametit do të kapet si në grusht (tek Allahu), ndërsa qiejt do të jenë të palosur në dorën e Tij. Qoftë i Lartësuar dhe i Lartmadhëruar Ai nga ajo çka i bëjnë idhujtari (shok-rival)”. (Ez-Zumer, 67)

Allahu Lartmadhëruar thotë:

“Thuaj: O Zoti im, Ti je Sundimtar i të gjithë sundimeve, i jep sundim kujt do Ti, e zbret nga sundimi kënd të do Ti. E ngrit cilin dëshiron, e ulë cilin dëshiron. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde. Vërtet Ti ke mundësi për gjithçka”.

(Ali Imran, 26)

Gjithësia, me tërë tokën e saj, me qiellin, për tjerat çka i dimë e çka nuk i dimë, Allahu është pronësues i tyre dhe Ai është marrës i tyre.

A, pas gjithë kësaj njohurie, ende nuk e ke forcuar bindjen në Allahun e Lartmadhëruar?!

SHEMBUJ TË ATYRE QË KANË PASUR BINDJE TË PLOTË NË ALLAHUN E LARTMADHËRUAR

**Bindja e të dërguari të Allahut s.a.v.s. në
Zotin e Tij**

Transmeton Enesi r.a. se i ka treguar Ebu Bekri r.a., se kur ka qenë në shpellë me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe kur i ka parë dhe i ka ndier hapat e idhujtarëve, të cilët janë afruar në hyrje të shpellës, i kam thënë: - O i Dërguar i Allahut, nëse ndonjëri prej tyre bën vetëm një lëvizje të vogël në drejtim tonin, do të na sheh. - Ndërsa Muhamedi a.s. ka thënë: “Çka mendon ti kur të jenë dy vetë, ndërsa me ta është i treti – Allahu?!” (Sahihul Buhari, 4298)

Vëlla!!

A është e logjikshme që të të lëkundet bindja në Allahun e Lartmadhëruar, ndërsa Pejgamberi yt, Muhamedi s.a.v.s. ka qenë Imam dhe prijës i atyre që kanë pasur bindje të thellë në Allahun e Lartmadhëruar.

Edhe nëse e tërë bota ngrihet kundër neve dhe na ndërpriten të gjitha rrugët, nuk duhet që të lëkundet bindja jonë në Allahun e Lartmadhëruar asnjëherë, por duhet të kemi bindje të fortë dhe të thellë si kodrat. Kjo është pjesa kryesore e betejës në të cilën jemi dhe të cilën dëshirojmë ta fitojmë; ndihma është prej Allahut të Lartmadhëruar, e nëse e humbin besimin në ndihmën e Allahut të Lartmadhëruar, kush pos Tij mund të na ndihmojë?!

Nëse umeti dëshiron jetë krenar e i mburrur, duhet ta ketë bindjen e fortë te Krijuesi i tyre dhe Zoti i tyre, duhet ta ketë bindjen e thellë në Allahun, dhe të mos lejojë të lëkundet asnjëherë.

Bindja e Musa a.s. në Zotin e Tij

Kur'ani Fisnik e ka paraqitur dhe e ka treguar qartë bindjen e thellë të Musa a.s. në Zotin e Tij. Në ato paraqitje shihet qartë bindja e Musa a.s. për çdo njeri, i cili dëshiron të ketë bindje të thellë dhe ka logjikë të shëndoshë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe Ne i shpallëm Musasë, që sa më parë të udhëtojë në mes të natës me njerëzit e mi (të devotshëm), sepse do t’ju ndjekin. Ndërsa Firauni dërgoi nëpër qytete kasnecët (tubuesit e ushtarëve) (duke u thënë atyre): Me të vërtet këta janë një grup i vogël, të cilët na kanë pezmatuar neve. Por Ne, gjithnjë jemi të gatshëm! Dhe, Na, i kemi dëbuar ata

(Firaunin dhe ushtrinë e tij) prej kopshteve dhe lumenjve, nga thesaret dhe pallatet fisnike. Ja kështu ka qenë, dhe (këtë) Ne i lamë trashëgim bijve të Israilit. Dhe, ata (Firauni me ushtrinë e tij) iu afruan atyre herët në mëngjes. E kur u takuan dy grupet dhe panë përballë njëra-tjetrën, Musait a.s. i thanë shokët e tij: na zunë! Musa a.s. u tha atyre: Jo, kurrsesi jo, se me të vërtetë me mua është Zoti im, i Cili do të më bëjë zgjidhje dhe do të ma lirojë rrugën. Dhe Ne i shpallëm Musasë: Bjeri me shkop detit! Ai i ra e (deti) u nda në dysh, dhe secila anë u bë si të ishte kodër e madhe. (Pasi israilët) kaluan (në mes të anëve) u afruan tjerët. Musanë dhe të gjithë ata që ishin me të i shpëtuan, ndërsa të tjerët (ushtrinë dhe Firaunin) i përmbytëm. Vërtet në këto (tregime) ka argumente, por prapë shumica e tyre nuk besojnë dhe nuk janë besimtarë. E Zoti yt me të vërtetë është i Plotfuqishëm dhe i Mëshirshëm”.

(Esh-Shuaraë: 52-68)

Bindja e të dërguarit Nuhë s.a.v.s. në Zotin e tij

Zoti i Lartmadhëruar e ka mësuar Nuhin a.s. se nuk do t'i besojnë atij, pos atyre që veç më i kishin besuar, andaj të mos dëshpërohej dhe të mos e humbë shpresën asnjëherë, pastaj Zoti i Lartmadhëruar e ka urdhëruar të ndërtojë një anije në mes të kodrës shkretinore, në të cilën nuk kishte as deti, as liqë e as lum. Në një vend ku kufri dhe pabesimi kishin arritur

në kulminacion, ndërsa besimtarët ishin të dobët dhe të paktë: ***“Dhe ndërto anijen, me konstruksionin Tonë, me frymëzimin Tonë dhe me mbikëqyrjen Tonë”.*** (Hud, 37)

A e dini se si e ka ndërtuar anijen Nuh i a.s. i ka mbjellë fidanët që të mbinë dhe të rriten, pastaj t’i presë dhe t’i bëjë dërrasa, për ta ndërtuar anijen. A është kjo e logjikshme?!

Të gjitha këto i ka bërë dhe ka pritur derisa pabesimtarët kanë qenë të shumtë, të fortë dhe i kanë pasur të gjitha të mirat, e Allahu nuk i ka shkatërruar deri në atë kohë. Paramendoje veten tënde me besimtarët dhe me Nuhin a.s., derisa ai e ka ndërtuar anijen në atë shkretëtirë!!

Si do të kishe vepruar? A do të ishte lëkundur bindja jote apo jo?!

Vërtet, ka qenë bindje e fortë në Allahun, e pa imagjinuar, bindje në urtësinë dhe fuqinë e Allahut pa kufi!!

Vëllezër!!

Ne kemi nevojë për ndërtimin e anijes, e cila na shpëton nga kriza, fatkeqësia dhe tragjedia, e ajo anije është, anija e bindjes së plotë në Allahun e Lartmadhëruar.

Ne kemi nevojë të rrekemi punës dhe të praktikojmë ligjin Allahut:

“Vërtet Allahu kurrë nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa mos ta ndryshojnë ata gjendjen e tyre”. (Err-RRaëd, 11)

Sikur të ndërtohej kjo anije në zemrat tona dhe të ngulitej në ne, dhe sikur t’i ktheheshim në vepër programit hyjnor, në këtë ligj, do të shpëtonim të gjithë së bashku, dhe do të triumfonim kundër armiqve tanë.

Vëlla!! Mos thuaj: *“Unë nuk shoh kurrfarë shprese”*. Shkretëtira e Nuhut a.s. është e njëjta shkretëtirë e realitet tonë. Besimtarët e kanë ndërtuar dhe kanë hipur në atë anije, e cila gjendej në mes të shkretëtirës. A e dini pse ata kanë hipur në atë anije?! Sepse kanë pasur bindje të thellë në Zotin e tyre të Lartmadhëruar.

Ndërsa ne, a posedojmë po atë bindje, të cilën e kanë pasur ata, për t’u realizuar ajo çka është realizuar te ata, përkrahja dhe ndihma.

Mbille dhe përforcoje bindjen tënde në zemrën tënde. Unë jam i bindur plotësisht në ndihmën dhe përkrahjen e Allahut për islamin dhe muslimanët, derisa ata do ta qeverisin botën, por me kusht që ata t’i kthehen praktikimit të programit qiellor për ndryshimin e gjendjes:

“... DERISA ATA MOS TA NDRYSHOJNË GJENDJEN E TYRE”.

* * *